



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 395/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.06.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*” me Nr.REF-74173-03-27-2017, me objekt: “*Rikonstruktion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të Bashkisë Dibër*”, me fond limit 6.463.338 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 07.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër

**Ankimues:**

“Shehu” shpk  
Lagjia “Maqellarë” Dibër

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Dibër  
Adresa : Peshkopi

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e*

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.03.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim” me Nr.REF-74173-03-27-2017, me objekt: “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të Bashkisë Dibër”, me fond limit 6.463.338 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 07.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër

II.2. Në datën 29.03.2017, operatori ekonomik ankimues “Shehu” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

### Konstatimi i I-rë

2.1 Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese Liçensen profesionale te shoqerise duke deshmuar se zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- a) • NP –1/A Punime gjurmimi në tokë.
- b) • NP –2/A Ndertime civile dhe industriale, ...
- c) • NP-- 7 /A Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa.....
- d) • NP –9/A Punime dhe mbrojtje lumore,sisteme hidraulike ,bonifikime
- e) • NP--12 /A Punime te inxhinierise se mjedisit.
- f) • NS--4 /A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to.....
- g) • NS—8/A Ndertime parafabrikate,beton arme,struktura metalike dhe druri.


### Konstatimi i II-rë

2.2 Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese dokumentacion qe verteton qe per periudhen Shkurt 2015, Shkurt 2017, ka pasur te punesuar per kete periudhe jo me pak se 20 punonjes ( pa perfshire edhe stafin tekniko menaxherial ). Punetoret te jene te deklaruar me kohe te plote.

### Konstatimi i III-rë

2.3 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon inxhinierë për drejtimin/kryerjen e të gjitha llojeve të punimeve në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të dëshmojë se ka të punësuar si drejtues teknik inxhinieret e meposhtem ne Licencen e kompanise :

- Inxhinierë topografe
- Inxhinier ndertimi
- Inxhinier mjedisi



Kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri.

### Konstatimi i VI

2.6 Përveç inxhinierëve të sipërpërmendur, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar: edhe nje inxhinier Hidraulik dhe nje inxhinier Hidroteknik si dhe nje Teknik ndërtimi dhe nje Teknik topograf te shoqëruar me dëftesë (diplomë) kontratë individuale të punës, si dhe CV te punësuar per periudhen Shkurt 2015-Shkurt 2017.

### Konstatimi i V

3.1 Dëshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund t`i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Kamion kapaciteti ngarkeses minimumi 10 ton	copë 2
Motogjeneratore	cope 1

<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë 1</i>
<i>Mini eskavator</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamioncina deri ne 3 ton</i>	<i>copë 3</i>
<i>Betoniera 200 lt</i>	<i>copë 7</i>
<i>Motokompresor</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamion APV me vinc</i>	<i>cope 1</i>
<i>Saldatrice me Argon 400A</i>	<i>copë 2</i>
<i>Makine elektrofuzive per tuba</i>	<i>cope 1</i>
<i>Kalleperi per beton (te pakten)</i>	<i>200 m2</i>
<i>Kokorre pune minimumi</i>	<i>cope 27</i>
<i>Fikese zjarri te levizeshmeme kapacitet 5-7 lt</i>	<i>cope 6</i>
<i>Komplete te ndihmes se shpejte</i>	<i>cope 6</i>
<i>Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt</i>	<i>cope 8</i>

*-Per mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), Certificate e Kontrollit Teknik siguracion*

*-Per makinerite qe nuk shenohen ne rregjistrat publike , duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre .*

*-Per mjetet e marra me qera, formularit dhe dokumentave te mesiperme t'i bashkelidhen kontrata e qerese, afati i marrjes me qira ,objektin, te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate ne rast te shpalljes fitues.*

*Po japim shpjegime Konstatimi i I-rë*

*2.1 Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese Licensen profesionale te shoqerise duke deshmuar se zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

- h) • NP –1/A Punime gjermimi në tokë.*
- i) • NP –2/A Ndertime civile dhe industriale, ...*
- j) • NP-- 7 /A Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa.....*
- k) • NP –9/A Punime dhe mbrojtje lumore,sisteme hidraulike ,bonifikime*

- l) • NP--12 /A Punime te inxhinierise se mjedisit.
- m) • NS--4 /A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to.....
- n) • NS—8/A Ndertime parafabrikate,beton arme,struktura metalike dhe druri.

Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 të vkm-së nr. 914 datë 29.12.2014 RrPP-së preventivit të kontratës që do të prokurohet dhe vkm-në nr. 42 datë 16.01.2008 lidhja 3 (rregullat e licencimit)sqarojmë si më poshtë:

Kërkohet NP-9/A Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike bonifikime NP-12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit e tre pika NS-8/A Ndërtime parafabrikat beton arme struktura metalike dhe druri. Nëse shohim preventivin e punimeve nuk kemi asnjë zë punmimesh ku të përfshihen pikat si më lartpërmendur. Pikën NP9/A duhet të hiqet sepse e mbulon pika NP7/A ujësjellësa gazësjellësa vajësjellësa, vepra kullimi e vaditje për të cilin bie dakord dhe preventivi i zërave. Edhe dy pika e tjera të lartpërmendura duhet të hiqen sepse bien në kundërshtim me kërkesat e preventivit. Nëse shohim preventivin e punimeve nuk kemi asnjë zë pune ku të përfshihen këto dy pika NP12A e NS8/A. Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së thuhet që kriteret e vecanta duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Në cdo rast autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin oe-të për përmbushjen e këtyre kriterëve. Këto tre kategori të kërkuara nga ak-ja nuk kanë asnjë lidhje me punimet e kontratës së objektit që prokurohet, përkundrazi në shkelje të nenit 26 pika 5 dhe 8. Duke u mbështetur në konstatimet e mësipërme duhet hiqen pikat e licencës të kërkuara nga ana jonë.

Po japim shpjegime Konstatimi i II

2.2 Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese dokumentacion qe verteton qe per periudhen Shkurt 2015, Shkurt 2017, ka pasur te punesuar per kete periudhe jo me pak se 20 punonjes ( pa perfshire edhe stafin tekniko menaxherial ). Punetoret te jene te deklaruar me kohe te plote.

AK-ja kërkon që të gjithë punonjësit të kërkuar më sipër duhet të jenë në listëagesa. Duke u mbështetur në VKM-në nr. 914 datë 29.12.2014 nxitjen e pjesmarrësve në një procedurë prokurimi publik mund të lihet hapsirë që për këta punonjës mund të paraqiten dhe kontrata të lidhura ndërmjet tyre dhe oe ku të specifikohet emërtimi i objektit. Dhe është shumë e zgjeruar që nga viti 2015 (para 3 vjetësh)në një procedurë prourimi me një vlerë të tillë dhe me një afat 20 ditë të zbatimit të kontratës është e pamundur që një biznes i mesëm të ketë të gjithë këto të siguruar në listëpagesa, e rëndësishme është që ai paraqet kontratë pune të lidhur për objektin në fjalë. Ku pjesën më të madhe të punimeve do të bëhen me makineri (edhe sipas preventivit). Duke u nisur nga më lartë kërkojmë zbutjen e nr. Të siguruarëve nga 20 në 10 me qëllim pjesmarrjen e sa më shumë oe në këtë procedurë prokurimi.

Po japim shpjegime Konstatimi III

2.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon inxhinierë për drejtimin/kryerjen e të gjitha llojeve të punimeve në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të dëshmojë se ka të punësuar si drejtues teknik inxhinieret e mëposhtem ne Licencen e kompanise :

- Inxhinierë topografe
- Inxhinier ndertimi

- Inxhinier mjedisi

Ak-ja Bashkia Dibër kërkon që oe –të të kenë drejtues teknik inxhinier topograf e mjedisi për të kryer punimet e parashikuara në preventiv. Kontrat që prokurohet "Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Maqellarë; Melan; Muhur; Tomin të Bashkisë Dibër. Këto punime kryhen nga inxhinieri i ndërtimit, ndërsa inxhinierët e tjerë nuk kryejnë asnjë punë në kontratë.

Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri duke hequr inxhinierët topograf e mjedisi

Po japim shpjegime konstatimi IV

2.6 Përvec inxhinierëve të sipërpërmendur, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar: edhe nje inxhinier Hidraulik dhe nje inxhinier Hidroteknik si dhe nje Teknik ndërtimi dhe nje Teknik topograf te shoqëruar me dëftesë (diplomë) kontratë individuale të punës, si dhe CV te punësuar per periudhen Shkurt 2015-Shkurt 2017.

Ak-ja Bashkia Dibër kërkon që oe –të të kenë drejtues inxhinier hidraulik dhe inxhinier hidroteknik si dhe një teknik ndërtimi dhe një teknik topograf të shoqëruar me dëftesë diplomë kontratë individuale të punës si dhe cv të të punësuarve për periudhën Shkurt 2015 shkurt 2017 për të kryer punimet e parashikuara në preventiv.Kontrata që prokurohet "Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Maqellarë; Melan; Muhur; Tomin të Bashkisë Dibër". Këto punime kryhen nga inxhinieri i ndërtimit ndërsa të tjerët nuk kryejnë asnjë punë në këtë kontratë.

Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri duke hequr inxhinierin hidraulik, hidroteknik, si dhe një teknik ndërtimi dhe një teknik topograf të shoqëruar me dëftesë (diplomë) kontratë individuale të punës si dhe cv-në të punësuar për periudhën shkurt 2015 shkurt 2017 mekanik topograf dhe gjeolog.

Po japim shpjegime konstatimi V

3.1 Dëshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund t`i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Kamion kapaciteti ngarkeses minimumi 10 ton	copë 2
Motogjeneratore	cope 1
Fadrome me goma	copë 1
Mini eskavator	copë 1
Kamioncina deri ne 3 ton	copë 3
Betoniera 200 lt	copë 7

<i>Motokompresor</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamion APV me vinc</i>	<i>cope 1</i>
<i>Saldatrice me Argon 400A</i>	<i>copë 2</i>
<i>Makine elektrofuzive per tuba</i>	<i>cope 1</i>
<i>Kalleperi per beton (te pakten)</i>	<i>200 m2</i>
<i>Kokorre pune minimumi</i>	<i>cope 27</i>
<i>Fikese zjarri te levizeshmeme kapacitet 5-7 lt</i>	<i>cope 6</i>
<i>Komplete te ndihmes se shpejte</i>	<i>cope 6</i>
<i>Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt</i>	<i>cope 8</i>

*-Per mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), Certificate e Kontrollit Teknik siguracion*

*-Per makinerite qe nuk shenohen ne rregjistrat publike , duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre .*

*Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së në preventivin e punimeve në specifikimet teknike dhe në legjislacionin e ndërtimit makineritë që nevojiten për të zbatuar dhe realizuar këtë kontratë sipas projektit janë shumë të zmadhuara në sasi dhe në zëra të ndryshëm që pjesa më e madhe del jashtë kapacitetit të kontratës dhe preventivit. Referojmë nenin 46 të LPP-së[...] neni 28 Pika 5 të VKM-së RrPP-së. [...]*

*Duke u nisur sa më lart kërkojmë të bëhet modifikimi i pjesshëm i këtyre pikave duke i hequr fare*

<i>Saldatrice me Argon 400A</i>	<i>copë 2</i>
<i>Makine elektrofuzive per tuba</i>	<i>cope 1</i>
<i>Kalleperi per beton (te pakten)</i>	<i>200 m2</i>
<i>Kokorre pune minimumi</i>	<i>cope 27</i>
<i>Fikese zjarri te levizeshmeme kapacitet 5-7 lt</i>	<i>cope 6</i>
<i>Komplete te ndihmes se shpejte</i>	<i>cope 6</i>
<i>Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt</i>	<i>cope 8</i>

Të gjitha këto pajisje që janë kërkuar nuk bëjnë të mundur realizimin e asnjë zëri pune pasi theksojmë kemi të bëjmë me rikonstruksione dhe mirëmbajtje kanalesh në bashkinë Dibër kërkojmë modifikimin e këtyre kritereve duke i hequr fare.

Ndaj këtyre kritereve të vendosura nga AK-ja Bashkia Dibër po paraqesim formularin e ankesës.

II.3. Në datën 03.04.2017, nëpërmjet shkresës nr. 1496/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur.

II.4. Në datën 10.04.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 19.04.2017, nëpërmjet shkresës me nr.1860/1 prot., datë 24.04.2017, me objekt: “Informacion për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të Bashkisë Dibër”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shehu” sh.p.k.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kategoritë e licencës se “2.1 Kandidati/ofertuesi duhet të paraqese Liçensën profesionale të shoqërisë duke deshmuar se zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- o) • NP –1/A Punime gjurmimi në tokë.
- p) • NP –2/A Nderime civile dhe industriale, ...
- q) • NP-- 7 /A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa.....
- r) • NP –9/A Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike ,bonifikime
- s) • NP--12 /A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- t) • NS--4 /A Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to.....
- u) • NS—8/A Nderime parafabrikate, beton arme, struktura metalike dhe druri.

Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 të vkm-së nr. 914 datë 29.12.2014 RrPP-së preventivit të kontratës që do të prokurohet dhe vkm-në nr. 42 datë 16.01.2008 lidhja 3 (rregullat e licencimit) sqarojmë si më poshtë:



Kërkohet NP-9/A Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike bonifikime NP-12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit e tre pika NS-8/A Ndërtime parafabrikat beton arme struktura metalike dhe druri. Nëse shohim preventivin e punimeve nuk kemi asnjë zë punmimesh ku të përfshihen pikat si më lartpërmendur. Pikën NP9/A duhet të hiqet sepse e mbulon pika NP7/A ujësjellësa gazësjellësa vajësjellësa, vepra kullimi e vaditje për të cilin bie dakord dhe preventivi i zërave. Edhe dy pika e tjera të lartpërmendura duhet të hiqen sepse bien në kundërshtim me kërkesat e preventivit. Nëse shohim preventivin e punimeve nuk kemi asnjë zë pune ku të përfshihen këto dy pika NP12A e NS8/A. Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së thuhet që kriteret e vecanta duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Në cdo rast autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin oe-të për përmbushjen e këtyre kriterëve. Këto tre kategori të kërkuara nga ak-ja nuk kanë asnjë lidhje me punimet e kontratës së objektit që prokurohet, përkundrazi në shkëlqje të nenit 26 pika 5 dhe 8. Duke u mbështetur në kostatimet e mësipërme duhet hiqen pikat e licencës të kërkuara nga ana jonë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” pika 2.1., është kërkuar: “2.1 Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese Liçensen profesionale te shoqerise duke deshmuar se zoteron keto kategori lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- a) • NP –1/A Punime gjermimi në tokë.
- b) • NP –2/A Ndertime civile dhe industriale, ...
- c) • NP-- 7 /A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa.....
- d) • NP –9/A Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike ,bonifikime
- e) • NP--12 /A Punime te inxhinierise se mjedisit.
- f) • NS--4 /A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to.....
- g) • NS—8/A Ndertime parafabrikate, beton arme, struktura metalike dhe druri”.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit Shtojca 1 “Formulari i ofertës” është kërkuar:

Objekti: “Rikonstruksion dhe mirembajtje te kanaleve vaditese NJ.A. Maqellare, Melan, Muhur, Tomin te Bashkise Diber.”

Nr	Nr. An	Pershkrimi		Sasia	Cmimi per njesi	Cmimi Total
A		Kanali Mulliri Melan				
1	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar, toke e zakonshme	M3	35.0		

2	3.241	Beton C12/15 (veshje kanali)	M3	77.7		
3	2.37/1b	Transport materiale me kafshe, deri 1.0 km	Ton	35		
4	4.60	F.V tub çeliku d= 219/sp 4 mm L = 29 ml	Kg	604.00		
		Shuma A				
B		Kanali Ushqyes i rezervuarit Kuplane				
1	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar + pastrime 1200	M3	350.0		
2	3.241	Beton per kanal in C12/15	M3	81.37		
3	3.323	Mur guri llac cim M50	M3	47.64		
4	2.37/1b	Transport materiale me kafshe, deri 1.0 km	Ton	70		
5	4.6	Tub celiku d=406, sp=4mm, L=10m	Kg	390		
6	3.97/d	Germime me makineri	M3	225		
		Shuma B				
C		Kanali Kercisht i Poshtem				
1	3.44/1	Germim kanalesh, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>	M3	100		
2	3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	Ml	500		
3	2.19	Hedhje, mbushje dheu me krah, kategoria III	M3	80		
4	3.241	Beton per bllokazhe C12/15	M3	3.2		
5	2.37/3b	Transport materiale me kafshe per bllokazhe, deri 3.0 km	Ton	16.2		

6	3.241	Beton per pusete C15/20 , 6 cope	M3	5.80		
7	2.37/3b	Transport materiale me kafshe, per pusete deri 3.0 km	Ton	31		
		Shuma C				
D		Kanali Kercisht i Eperm L=550ml				
1	3.44/1	Germim kanalesh, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>	M3	120	723	
2	3.241	Beton per pusete C15/20 , 6 cope	M3	72.60	10,603	
		Shuma D				
E		Kanali Muhurr-Brezhdan (vepra e marrjes)				
1	3.241	Beton per kanal in C12/15	M3	30	10,603	
2	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 10mm	Kg	185	107	
3	631-632	Suvatim me llac cim M 25, 50, ne mure betoni	M2	100	462	
4	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar ,	M3	90	620	
5	2.37/3b	Transport me kafshe per pusete deri 3.0 km	Ton	54	6137	
		Shuma E				
F		Kanali Llixha-Brezhdan-Kander				
1	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar, hapje kanali (Degezimi Kander)	M3	320.0	620	

2	4.70	<i>F.V. tuba perfshi pjeset speciale me saldim me llamarine te zeze te kalandruar te vendosur ne estakada ÷φ600</i>	<i>Kg</i>	<i>168</i>	<i>167</i>	
3	3.97/d	<i>Germime me makineri per heqjen e tubacionin</i>	<i>M3</i>	<i>70</i>	<i>295</i>	
4	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	<i>M3</i>	<i>400.0</i>	<i>620</i>	
		<i>Shuma F</i>				
<i>G</i>		<i>Kanali Perroi i Llixhave-Lagjia Dobrove</i>				
<i>1</i>	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	<i>M3</i>	<i>200.0</i>	<i>620</i>	
		<i>Shuma G</i>				
		<i>Kanali Perroi i Lixhave-Lagjia Varend</i>				
	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	<i>M3</i>	<i>150.0</i>	<i>620</i>	
		<i>Kanali ujites Shallvare-Selane</i>				
	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	<i>M3</i>	<i>100.0</i>	<i>620</i>	
		<i>SHUMA TOTALE</i>				
		<i>T.V.SH 20%</i>				
		<i>SHUMA ME T.V.SH</i>				

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, geramat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.1.3. Në nenin 26 pika 5 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.4. Në VKM-në nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridikë, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar Kreu I “Qëllimi fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime” parashikon se: Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij. Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje. [...]

Në lidhjen 3 parashikohet se: [...]

#### N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

#### N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si

*do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e rregjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve*

*N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri*

*Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.*

*Prodhimin në kantjer dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.*

*Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

III.1.6. Në rastin konkret, objekti i prokurimit është "Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të Bashkisë Dibër", nisur edhe nga zërat e punimeve si edhe nga vlera e objektit të prokurimit, autoriteti kontraktor kërkon të krijojë një panoramë të përgjithshme për verifikimin e kapaciteteve të shoqërive pjesëmarrëse, të cilët duhet të vërtetojnë se disponojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm, në lidhje me kategoritë e licencës konkretisht: "N.P. 9 A; N.P. 12/A; dhe N.S – 8/A;", referuar bazës ligjore të sipërcituar si dhe shtojcës 1 të dokumentave të tenderit konkretisht formularit të ofertes (përshkrimi i punëve), është në proporcion me natyrën e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e ka gjykuar si të domosdoshme kërkesën për kategoritë e punimeve N.P. 9 A; N.P. 12/A; dhe N.S – 8/A, të cilat lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe janë në përpjesëtim me kontratën objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për numrin e punonjësve të siguruar se "2.2 Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që verteton që për periudhën Shkurt 2015, Shkurt 2017, ka pasur të punësuar për këto periudha jo më pak se 20 punonjës ( pa përfshire edhe stafin tekniko menaxherial ). Punetoret të jene të deklaruar me kohe të plote.

AK-ja kërkon që të gjithë punonjësit të kërkuar më sipër duhet të jenë në listëagesa. Duke u mbështetur në VKM-në nr. 914 datë 29.12.2014 nxitjen e pjesëmarrësve në një procedurë prokurimi publik mund të lihet hapsirë që për këta punonjës mund të paraqiten dhe kontrata të lidhura ndërmjet tyre dhe oë ku të specifikohet emërtimi i objektit. Dhe është shumë e zgjeruar që nga viti 2015 (para 3 vjetësh) në një procedurë prokurimi me një vlerë të tillë dhe me një afat 20 ditë të zbatimit të kontratës është e pamundur që një biznes i mesëm të ketë të gjithë këto të siguruar në listëpagesa, e rëndësishme është që ai paraqet kontratë pune të lidhur për objektin në fjalë. Ku pjesën më të madhe të punimeve do të bëhen me makineri (edhe sipas preventivit). Duke u nisur nga më lartë kërkojmë zbutjen e nr. Të siguarëve nga 20 në 10

me qëllim pjesmarrjen e sa më shumë oe në këtë procedurë prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” pika 2.2., është kërkuar:

2.2 Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese dokumentacion qe verteton qe per periudhen Shkurt 2015, Shkurt 2017, ka pasur te punesuar per kete periudhe jo me pak se 20 punonjes ( pa perfshire edhe stafin tekniko menaxherial ). Punetoret te jene te deklaruar me kohe te plote.

III.2.2. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Objekti: “Rikonstruksion dhe mirembajtje te kanaleve vaditese NJ.A. Maqellare, Melan, Muhur, Tomin te Bashkise Diber.”

Nr	Nr. An	Pershkrimi		Sasia	Cmimi per njesi	Cmimi Total
A		Kanali Mulliri Melan				
1	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar, toke e zakonshme	M3	35.0		
2	3.241	Beton C12/15 (veshje kanali)	M3	77.7		
3	2.37/1b	Transport materiale me kafshe, deri 1.0 km	Ton	35		
4	4.60	F.V tub çeliku d= 219/sp 4 mm L = 29 ml	Kg	604.00		
		Shuma A				
B		Kanali Ushqyes i rezervuarit Kuplane				
1	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar + pastrime 1200	M3	350.0		

2	3.241	Beton per kanal in C12/15	M3	81.37		
3	3.323	Mur guri llac cim M50	M3	47.64		
4	2.37/1b	Transport materiale me kafshe, deri 1.0 km	Ton	70		
5	4.6	Tub celiku d=406, sp=4mm, L=10m	Kg	390		
6	3.97/d	Germime me makineri	M3	225		
		Shuma B				
C		Kanali Kercisht i Poshtem				
1	3.44/1	Germim kanalesh, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>	M3	100		
2	3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	Ml	500		
3	2.19	Hedhje, mbushje dheu me krah, kategoria III	M3	80		
4	3.241	Beton per bllokazhe C12/15	M3	3.2		
5	2.37/3b	Transport materiale me kafshe per bllokazhe, deri 3.0 km	Ton	16.2		
6	3.241	Beton per pusete C15/20 , 6 cope	M3	5.80		
7	2.37/3b	Transport materiale me kafshe, per pusete deri 3.0 km	Ton	31		
		Shuma C				
D		Kanali Kercisht i Eperm L=550ml				
1	3.44/1	Germim kanalesh, me krahe, me seksion deri 0.75 m <sup>2</sup>	M3	120	723	



2	3.241	Beton per pusete C15/20 , 6 cope	M3	72.60	10,603	
		Shuma D				
E		Kanali Muhurr-Brezhdan (vepra e marrjes)				
1	3.241	Beton per kanalin C12/15	M3	30	10,603	
2	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 10mm	Kg	185	107	
3	631-632	Suvatim me llac cim M 25, 50, ne mure betoni	M2	100	462	
4	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar ,	M3	90	620	
5	2.37/3b	Transport me kafshe per pusete deri 3.0 km	Ton	54	6137	
		Shuma E				
F		Kanali Llixha-Brezhdan-Kander				
1	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar, hapje kanali (Degezimi Kander)	M3	320.0	620	
2	4.70	F.V. tuba perfshi pjeset speciale me saldim me llamarine te zeze te kalandruar te vendosur ne estakada ÷φ600	Kg	168	167	
3	3.97/d	Germime me makineri per heqjen e tubacionin	M3	70	295	
4	3.25/b	Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime	M3	400.0	620	
		Shuma F				

G		<i>Kanali Perroi i Llixhave-Lagjia Dobrove</i>				
1	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	M3	200.0	620	
		<i>Shuma G</i>				
		<i>Kanali Perroi i Lixhave-Lagjia Varend</i>				
	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	M3	150.0	620	
		<i>Kanali ujites Shallvare-Selane</i>				
	3.25/b	<i>Germim me krahe seksion I detyruar , pastrime</i>	M3	100.0	620	
		<i>SHUMA TOTALE</i>				
		<i>T.V.SH 20%</i>				
		<i>SHUMA ME T.V.SH</i>				

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, germat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurrohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.2.3. Në nenin 26 pika 5 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

[...]

Pika 8 “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.2.4. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlereson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës.

III.2.5. Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 20 punonjësish duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë një shërbim me cilësi të objektit si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve e cila në rastin konkret nuk është i argumentuar dhe justifikuar nga autoriteti kontraktor.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e punëve të nevojshme që do të kryhen për realizimin e kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit sa më sipër duke vendosur një numër të arsyeshëm punonjësish dhe proporcional me objektin e prokurimit në respekt të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me periudhën që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin “dokumentacion që vërteton që për periudhën Shkurt 2015, Shkurt 2017”, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke kërkuar një kohë më të shkurtër në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për inxhinierët se “ *Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon inxhinierë për drejtimin/kryerjen e të gjitha llojeve të punimeve në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të dëshmojë se ka të punësuar si drejtues teknik inxhinieret e mëposhtem në Licencën e kompanisë :*

- *Inxhinierë topografe*
- *Inxhinier ndertimi*
- *Inxhinier mjedisi*

*Ak-ja Bashkia Dibër kërkon që oë –të të kenë drejtues teknik inxhinier topograf e mjedisi për të kryer punimet e parashikuara në preventiv. Kontrat që prokurohet ”Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse NJ.A. Maqellarë; Melan; Muhur; Tomin të Bashkisë Dibër. Këto punime kryhen nga inxhinieri i ndërtimit, ndërsa inxhinierët e tjerë nuk kryejnë asnjë punë në kontratë.*

*Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri duke hequr inxhinierët topograf e mjedisi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” pika 2.3., është kërkuar:

2.3. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon inxhinierë për drejtimin/kryerjen e të gjitha llojeve të punimeve në objekt. Për këtë ofertuesi duhet të dëshmojë se ka të punësuar si drejtues teknik inxhinieret e mëposhtem ne Licencen e kompanisë :

- Inxhinierë topografe
- Inxhinier ndertimi
- Inxhinier mjedisi

III.3.2. Në nenin 46, pika 1, geramat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operator ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.3.3. Në nenin 26 pika 5 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

[...]

Pika 8 “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.3.4. Në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që

*ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, parashikohet se: 1. “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrijë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: – profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë. II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente: – Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; – Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë; – Kapacitetet financiare.” Në Kreun IV të po kësaj VKM-je, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.”*

III.3.5. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor që “Operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar për drejtimin e punimeve në përberjen e të cilit duhet të jetë minimalisht: një inxhinier mjedisi; inxhinier topograf ” nuk është një kërkesë e ekzagjëruar është në proporcion me volumin dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për inxhinierët se “2.6 Përvec inxhinierëve të sipërpërmendur, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar: edhe nje inxhinier Hidraulik dhe nje inxhinier Hidroteknik si dhe nje Teknik ndërtimi dhe nje Teknik topograf te shoqëruar me dëftesë (diplomë) kontratë individuale të punës, si dhe CV te punësuar per periudhen Shkurt 2015-Shkurt 2017.

*Ak-ja Bashkia Dibër kërkon që oe –të të kenë drejtues inxhinier hidraulik dhe inxhinier hidroteknik si dhe një teknik ndërtimi dhe një teknik topograf të shoqëruar me dëftesë diplomë kontratë individuale të punës si dhe cv të të punësuarve për periudhën Shkurt 2015 shkurt 2017 për të kryer punimet e parashikuara në preventiv.Kontrata që prokurohet ”Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë; Melan; Muhur; Tomin të Bashkisë Dibër”. Këto punime kryhen nga inxhinieri i ndërtimit ndërsa të tjerët nuk kryejnë asnjë punë në këtë kontratë.*

Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri duke hequr inxhinierin hidraulik, hidroteknik, si dhe një teknik ndërtimi dhe një teknik topograf të shoqëruar me dëftesë (diplomë) kontratë individuale të punës si dhe cv-në të punësuar për periudhën shkurt 2015 shkurt 2017 mekanik topograf dhe gjeolog”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” pika 2.6., është kërkuar:

*2.6 Përvec inxhinierëve të sipërpërmendur, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar: edhe nje inxhinier Hidroteknik te punësuar per periudhen Shkurt 2015-Shkurt 2017.*

*Si dhe nje Teknik ndërtimi dhe nje Teknik topograf te shoqëruar me dëftesë (diplomë) kontratë individuale të punës, si dhe CV te punësuar per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates.*

III.4.2. Në nenin 46, pika 1, germat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.4.3. Në nenin 26 pika 5 “Kontratat për punë publike” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”

[...]

Pika 8 “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.4.4. Sa më sipër operatori ekonomik ankimues ka ngritur pretendimin në tërësi për kriterin Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se krahas detyrimit të paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës të mundshëm të dëshmive për staf të kualifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar edhe detyrimin e stafit të përfshirë në listëpagesa Shkurt 2015-Shkurt 2017. Në lidhje me këtë pikë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në respekt të testit në lidhje me proporcionalitetin kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor është më shumë sesa nevojitet për të realizuar synimin e kërkesës. Në këtë kontekst KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke kërkuar një kohë më të shkurtër në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Ndërsa në lidhje me stafin e kualifikuar konkretisht: “*teknik ndërtimi dhe topograf*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm nuk është në proporcion me objektin e prokurimit. Akoma më tej KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar kryerjen e punimeve nga drejtues teknik nivel inxhinieri. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit duke hequr specialistin topograf dhe teknikun e ndërtimit.

Në lidhje me inxhinierin hidroteknik Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa kohë në kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar NP9/A si kategori në licencën e operatorëve ekonomik, atëherë detyrimisht referuar kuadrit ligjor në fuqi dhe argumentimit të mësipërm shfaqet e nevojshme inxhinieri hidroteknik për kryerjen e punimeve referuar zërave të preventivit dhe objektit të prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për makineritë se “*3.1 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

<i>Kamion kapaciteti ngarkeses minimumi 10 ton</i>	<i>copë 2</i>
<i>Motogjeneratore</i>	<i>cope 1</i>
<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë 1</i>
<i>Mini eskavator</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamioncina deri ne 3 ton</i>	<i>copë 3</i>
<i>Betoniera 200 lt</i>	<i>copë 7</i>



<i>Motokompresor</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamion APV me vinc</i>	<i>cope 1</i>
<i>Saldatrice me Argon 400A</i>	<i>copë 2</i>
<i>Makine elektrofuzive per tuba</i>	<i>cope 1</i>
<i>Kalleperi per beton (te pakten)</i>	<i>200 m2</i>
<i>Kokorre pune minimumi</i>	<i>cope 27</i>
<i>Fikese zjarri te levizeshmeme kapacitet 5-7 lt</i>	<i>cope 6</i>
<i>Komplete te ndihmes se shpejte</i>	<i>cope 6</i>
<i>Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt</i>	<i>cope 8</i>

*-Per mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), Certificate e Kontrollit Teknik siguracion*

*-Per makinerite qe nuk shenohen ne rregjistrat publike , duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre .*

*Duke u mbështetur në nenin 26 pika 5 e vkm-së RrPP-së në preventivin e punimeve në specifikimet teknike dhe në legjislacionin e ndërtimit makineritë që nevojiten për të zbatuar dhe realizuar këtë kontratë sipas projektit janë shumë të zmadhuara në sasi dhe në zëra të ndryshëm që pjesa më e madhe del jashtë kapacitetit të kontratës dhe preventivit. Referojmë nenin 46 të LPP-së[...] neni 28 Pika 5 të VKM-së RrPP-së. [...]*

*Duke u nisur sa më lart kërkojmë të bëhet modifikimi i pjesshëm i këtyre pikave duke i hequr fare*

<i>Saldatrice me Argon 400A</i>	<i>copë 2</i>
<i>Makine elektrofuzive per tuba</i>	<i>cope 1</i>
<i>Kalleperi per beton (te pakten)</i>	<i>200 m2</i>
<i>Kokorre pune minimumi</i>	<i>cope 27</i>
<i>Fikese zjarri te levizeshmeme kapacitet 5-7 lt</i>	<i>cope 6</i>
<i>Komplete te ndihmes se shpejte</i>	<i>cope 6</i>
<i>Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt</i>	<i>cope 8</i>

Të gjitha këto pajisje që janë kërkuar nuk bëjnë të mundur realizimin e asnjë zëri pune pasi theksojmë kemi të bëjmë me rikonstruksione dhe mirëmbajtje kanalesh në bashkinë Dibër kërkojmë modifikimin e këtyre kritereve duke i hequr fare.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” pika 3.1., është kërkuar:

3.1 *Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund t`i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

<i>Kamion kapaciteti ngarkeses minimumi 10 ton</i>	<i>copë 2</i>
<i>Motogjeneratore</i>	<i>cope 1</i>
<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë 1</i>
<i>Mini eskavator</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamioncina deri ne 3 ton</i>	<i>copë 3</i>
<i>Betoniera 200 lt</i>	<i>copë 7</i>
<i>Motokompresor</i>	<i>copë 1</i>
<i>Kamion APV me vinc</i>	<i>cope 1</i>
<i>Saldatrice me Argon 400A</i>	<i>copë 2</i>
<i>Makine elektrofuzive per tuba</i>	<i>cope 1</i>
<i>Kalleperi per beton (te pakten)</i>	<i>200 m2</i>
<i>Kokorre pune minimumi</i>	<i>cope 27</i>
<i>Fikese zjarri te levizeshmeme kapacitet 5-7 lt</i>	<i>cope 6</i>
<i>Komplete te ndihmes se shpejte</i>	<i>cope 6</i>
<i>Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt</i>	<i>cope 8</i>

*-Per mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton*

regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), Certificate e Kontrollit Teknik siguracion

-Per makinerite qe nuk shenohen ne rregjistrat publike , duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre .

-Per mjetet e marra me qera, formularit dhe dokumentave te mesiper m t'i bashkelidhen kontrata e qerese, afati i marrjes me qira ,objektin, te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate ne rast te shpalljes fitues.

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.5.3. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.5.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

[...]

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që

operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (mjete), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e 8 (copë) Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, (6 copë) Fikëse Zjarri, complete të ndihmës së shpejtë 6 (copë), KPP konstaton se, këto mjete lidhen me kapacitetin teknik të operatorëve ekonomik në momentin e lidhjes së kontratës dhe fillimit të punimeve në kantier. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në bazë të nenit 62 të LPP-së, si dhe kuadrit ligjor që disiplinonë punimet në ndërtim është detyrim i operatorëve ekonomikë të disponojnë sigurinë në kantier sipas parashikimeve ligjore. Në këtë kuadër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt; Fikëset e Zjarrit; si dhe complete të ndihmës së shpejtë; duhet të hiqen.

III.5.6. Ndërsa në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të mundshëm pjesmarrës për “Saldatrice me argon 400 (2 copë), makinë elektrofuzive për tuba (1 copë), kallëperi për beton të paktën 200m<sup>2</sup>” Komisioni i Prokurimit Publik pas analizimit të zërave të punimeve që do të kryehen në objektin e prokurimit “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të Bashkisë Dibër”, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponimin e tyre është e nevojshme pasi janë mjete të cilat nevojiten për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Ndërsa në lidhje me disponueshmërinë e “Kokore pune minimum (27 copë)”, Komisioni gjykon se është një numër i ekzagjësuar i cili mund të ulë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë të mundshëm pjesmarrës. Autoriteti kontraktor në përcaktimin e numrit të këtyre “Kokore pune minimum (27 copë)”, duhet të mbajë në konsideratë përvec elementëve të parashikuar më sipër edhe nenin 1 pika 2 të LPP-së.

Në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterëve sa më sipër duke vendosur një numër të arsyeshëm “Kokore pune minimum (27 copë)”, dhe proporcional me objektin e prokurimit në respekt të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shehu” shpk për procedurën “Kërkesë për propozim” me Nr.REF-74173-03-27-2017, me objekt: “Rikonstruksion dhe

*mirëmbajtje të kanaleve vaditëse N.J.A. Maqellarë, Melan, Muhur, Tomin të Bashkisë Dibër”, me fond limit 6.463.338 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 07.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër*

2. Autoriteti kontraktues të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktues, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Shehu” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 707 Protokoli, Datë 10.04.2017**

**Zv/Kryetar  
Leonard Gremshi**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar  
Hektor Balluku**

**Anëtar  
Kleves Janku**

**Anëtar  
Odise Moçka**

**Kryetar  
Evis Shurdha**

